

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6494
E mërkurë, 22 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Nënshkruhet
marrëveshja për abetaren
e re të përbashkët
Kosovë - Shqipëri | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KËRKOHET FILLIMI I PROCESIT TË REFORMËS ZGJEDHORE



Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka pohuar se edhe pse Kosova ka arritur standarde demokratike sa i përket organizimit të zgjedhjeve,

tanimë duhet të fillojë procesi për reformën zgjedhore. Në tryezën e diskutimit me temën "Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021 dhe ndikimi i saj në punën e Kuvendit të Kosovës", ku

morën pjesë përfaqësues të subjekteve politike, KQZ-së dhe shoqërisë civile, u vlerësua shumë i rëndësishëm fillimi i reformës zgjedhore për vitin e ardhshëm

Arrestohet ish-kryetari i Shtërpcës dhe dhjetë persona të tjerë | FAQE 4-5



THEMELUESIT E 'BALLKANIT TË HAPUR' FIRMOSIN MARRËVESHJE TË REJA

| FAQE 4-5

AKTUALE



DEPUTETJA MUSLIU
E GJUAN ME UJË MINISTRIN PEÇI
DHE E QUAN RRUGAÇ | F. 3

MBAHET DIALOGU NDËRMINISTROR
PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN
PROFESIONAL NË KOSOVË | F. 6

MSH-ja, QYTETARËVE: MERRINI TË
GJITHA DOZAT E VAKSINËS
KUNDËR COVIDIT! | F. 7



EKONOMI



FINALIZOHET PROJEKTI I PISTËS
SË ANP 'ADEM JASHARI', ZGJATET
PËR 540 METRA | F. 8

SPORT



"BALLKANI" SHKARKON
TRAJNERIN BEKIM ISUFI | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja njih certifikatën për Covid-19 të Malit të Zi

BRUKSEL, 21 DHJETOR - Komisioni Evropian më 21 dhjetor njoftoi se një certifikatë për vaksinimin kundër koronavirusit që lëshohet nga autoritetet në Mal të Zi.

Komisioni konfirmoi se certifikatat për Covid-19 që lëshohen nga Mali i Zi janë "të barasvlefshme me certifikatat digjitale të Covid-19 që lëshohen nga Bashkimi Evropian", tha ky institucion i BE-së përmes një deklaratë. Përveç Malit të Zi, BE-ja ka vendosur që t'i njohë edhe

certifikatat e Tajvanit, Tajlandës, Tunizisë dhe Uruguait. Sipas njoftimit, ky vendim i KE-së do të hyjë në fuqi më 22 dhjetor. "Ky vendim del pas vlerësimit teknik të kryer nga shërbimet e BE-së për certifikatat që lëshohen nga këto pesë shtete dhe territore, dokumente të cilat do të inkorporohen në sistemin e BE-së. Blloku evropian do t'i trajtojë certifikatat e këtyre shteteve siç bën me certifikatat për Covid-19 të BE-së", tha Komisioni Evropian. Ky vendim nënkupton se çdo

person që ka certifikatë të lëshuar nga Mali i Zi mund ta përdorë atë me të njëjtat kushte sikurse një person që ka certifikatën digjitale të BE-së për Covid-19.

Nga shtetet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria tashmë kanë marrë konfirmimin për njohjen e certifikatave të tyre.

Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina janë shtetet e vetme në rajon, certifikatat e të cilave ende nuk njihen nga BE-ja.



OBSH-ja bën thirrje për anulim të disa organizimeve për shkak të "Omicron"-it



GJENEVE, 21 DHJETOR - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) u ka bërë thirrje njerëzve që t'i anulojnë disa plane për pushime në mënyrë që ta mbrojnë shëndetin publik, teksa varianti "Omicron" i koronavirusit përhapet në gjithë botën. "Një organizim i anuluar është lajm më i mirë sesa një jetë e anuluar", ka thënë shefi i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, duke

thënë se duhet marrë "vendime të vështira". "Në disa raste, kjo gjë do ta nënkuptojë anulimin apo shtyrjen e ngjarjeve", ka thënë ai. Deklaratat e tij kanë ardhur teksa ekspertët shëndetësorë kanë thënë se "Omicron"-i tani është variant dominues i koronavirusit në Shtetet e Bashkuara.

Shefi i OBSH-së ka thënë se ka të dhëna se varianti "Omicron" është duke u përhapur shumë

më shpejt sesa "Delta".

Një numër shtetesh, duke përfshirë Francën dhe Gjermaninë, kanë ashpërsuar kufizimet për pandeminë dhe kanë rikthyer kufizimet në udhëtime, me qëllim të luftimit të variantit të ri.

Shtëpia e Bardhë ka thënë të hënën se presidenti amerikan Joe Biden nuk planifikon "ta mbyllë shtetin".

Berisha: Mbyllja e dyerve të selisë së PD-së nga Lul Brava, akt i shëmtuar

TIRANË, 21 DHJETOR - Ish-lideri i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka mbajtur të martën konferencë për medie nga selia e kësaj partie. Ai ka thënë se bravat e ndërtesës së PD-së janë ndërruar vetëm nga Lulzim Basha duke shtuar se as ai apo anëtarët e Komisionit të Rithemelimit nuk kanë gisht në atë akt.

Në ambientet e selisë së PD-së, ku u thye një prej dyerve të kësaj selie, Berisha s'i ndali ironitë për

Bashën, që e cilësoi me epitelin 'Lul brava'.

Ndër të tjera, Berisha e quajti akt të turpshëm duke e cilësuar kryedemokratën si Lulzim Brava dhe se eksponentët e armëve dhe bandave nuk kanë vend në selinë e lirisë. "Kur një pakicë mendon të shtypë një shumicë ajo ose është totalitare ose është pakicë terroriste, ose pakicë banditeske, por një gjë është e sigurt, se kurrë një pakicë nuk duhet të tentojë ta injorojë

shumicën, por ta pranojë sundimin e saj brenda rregullave dhe normave që janë universale. Mbyllja e dyerve të selisë për PD-në nga peng Basha apo Lul Brava është akt i shëmtuar, siç është futja e eksponentëve të armatosur të qeverisë në selinë e demokratëve. Kjo është selia e lirisë dhe jo e armëve, nuk është Berisha as këta zotërinj të Komisionit që kanë bërë lojë me brava", ka thënë Berisha.



Rritet numri i viktimave në Malajzi si pasojë e vërshimeve



KUALA, 21 DHJETOR - Të paktën 14 persona kanë vdekur dhe dhjetëra mijëra janë zhvendosur si pasojë e vërshimeve më të mëdha në Malajzi për dekada.

Tri ditë me shira të rrëmbyeshëm kanë rezultuar me vërshime të mëdha në tetë rajone. Qeveria është

përballur me kritika të ashpra për përgjigje të vonuar.

Shumë persona janë raportuar të zhdukur dhe janë duke u rritur shqetësimet se numri i viktimave mund të rritet dukshëm.

Deri të martën vlerësohet se 51 000 persona janë evakuuar nga shtëpitë e tyre.

Nëpër disa rajone vërshime të tilla nuk janë parë prej vërshimeve masive të vitit 1971. Zyrtarët kanë thënë se mund të ketë shpërthime të reja të infektiveve me koronavirus, pasi mijëra persona janë mbledhur nëpër ambiente të përkohshme strehimi.

Kërkohet fillimi i procesit të reformës zgjedhore



Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka pohuar se edhe pse Kosova ka arritur standarde demokratike sa i përket organizimit të zgjedhjeve, tanimë duhet të fillojë procesi për reformën zgjedhore. Në tryezën e diskutimit me temën “Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021 dhe ndikimi i saj në punën e Kuvendit të Kosovës”, ku morën pjesë përfaqësues të subjekteve politike, KQZ-së dhe shoqërisë civile, u vlerësua shumë i rëndësishëm fillimi i reformës zgjedhore për vitin e ardhshëm

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim (DnV) ka organizuar të martën tryezën e diskutimit me temën “Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021 dhe ndikimi i saj në punën e Kuvendit të Kosovës” në një diskutim të hapur me përfaqësues të subjekteve politike,

KQZ-së dhe shoqërisë civile.

Në hapje të këtij diskutimi, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, ka theksuar se edhe pse Kosova ka arritur standarde demokratike sa i përket organizimit të zgjedhjeve, duhet të fillojë procesi për reformën zgjedhore. Ai ka thënë se në kuadër të këtij procesi duhet të krijohet kodi zgjedhor që përfshinë disa ligje që duhet t'i adresojnë problematikat e evidentuara në proceset

zgjedhore të mbajtura deri tash. DnV dhe KDI kanë paraqitur një raport dhe një analizë të shkurtër që trajtojnë në dy forma të ndryshme tematikat e tryezës.

Në prezantimin e raportit “Dy raunde të zgjedhjeve lokale - dy lloje fushatash”, Eugen Cakolli, ka thënë se në formatin e fushatës, dy raundet e zgjedhjeve shpërfaqën qasje të ndryshme nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre.

Sa iu përket programeve politike, u potencua se partitë kanë luajtur një rol në përgatitjen e platformave të kandidatëve të tyre, ndonëse është ruajtur një autonomi e konsiderueshme e kandidatëve dhe degëve respektive në këtë drejtim për shkak edhe të specifikave të ndryshme të komunave.

Kurse sa i përket gjuhës së përdorur nga kandidatët, ndonëse në nivel të përgjithshëm ajo ishte e balancuar. “Gjatë raundit të dytë,

rastet e acarimit të gjuhës dhe ashpërsimit të diskursit mes kandidatëve kanë qenë mjaft të shprehura, sidomos gjatë debateve televizive. Element tjetër i rëndësishëm që dëshmon për pjekurinë e subjekteve politike dhe kandidatëve në garë është pranimi i menjëhershëm i rezultatit zgjedhor”, ka thënë Cakolli.

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, ai ka paraqitur rekomandimet konkrete të DnV-së për përmirësimin dhe avancimin e fushatave zgjedhore në Kosovë, duke përfshirë shumë dimensionet e saj. Po ashtu, duke qenë se këtë vit Kosova ka përmbyllur me sukses dy procese zgjedhore, u ritheksua se është momentumi i duhur politik për iniciimin e procesit të reformës zgjedhore. Sipas të pranishmëve në këtë tryezë, reforma zgjedhore duhet ta përfshijë rishikimin e një sërë ligjesh, duke përfshirë Ligjin

për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike si dhe eventualisht ligjeve të tjera që preken nga ndryshimet në legjislacionin zgjedhor.

Përgjithësisht, të gjithë pjesëmarrësit e kësaj tryeze konsideruan se është shumë i rëndësishëm fillimi i reformës zgjedhore dhe viti i ardhshëm do të duhej të ishte koha e duhur që të fillojë dhe të përmbyllet suksesshëm ky proces.

Në kuadër të kësaj tryeze u prezantua edhe analiza “Ndikimi i zgjedhjeve lokale 2021 në punën e Kuvendit të Kosovës”.

Agnesa Haxhiu, gjatë prezantimit të saj, tha se fushata zgjedhore ka ulur dukshëm efikasitetin e punës së legjislativit për shkak të fokusit që partitë politike parlamentare kanë pasur në këtë proces zgjedhor, ku si garues morën pjesë rreth 15 për qind e përbërjes së kësaj legjislature.

Deputetja Musliu e gjuan me ujë ministrin Peci dhe e quan rrugaç

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER)-Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Ganimete Musliu e ka gjuajtur me ujë ministrin e Bujqësisë, Faton Peci dhe e ka quajtur rrugaç. “Ti je rrugaç”, ka thënë Musliu derisa e ka gjuajtur me ujë ministrin Peci. Kjo përplasje ndodhi të martën në mbledhjen e Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ku ministri Peci ishte duke raportuar para anëtarëve të këtij komisioni. Pas kësaj, ka reaguari ministri Peci, i cili ka deklaruar se sa të jetë ai ministër askush nuk do të mund të vjedh në Ministrinë e Bujqësisë. “Nuk ka për të vjedhur askush sa të jam unë ministër. Nëse doni gjuani me ujë, ose me

plumba qysh keni gjuajtur në të kaluarën. Nuk ka birë nane që e ndal Faton Peci. Sa të jem unë ministër, nuk munden për të vjedhur dotat e Ganes”, ka thënë ai.

E deputetja Musliu pas kësaj ngjarje ka mbajtur një konferencë për media, ku ka paralajmëruar padi ndaj ministrit të Bujqësisë. “Për akuzat që më bëri ministri duke më bërë pjesë të kriminit të organizuar, unë do të ngriti padi ndaj tij dhe do ta mbrojë dinjtetin tim si deputete e Kosovës”, ka thënë Musliu.

Ajo ka treguar se gjithë përplasja mes saj dhe ministrit Peci ka ardhur si rezultat i anulimit të vendimit për thirrjen e granteve për bujqit.





SHQIPËRIA, SERBIA DHE MAQEDONIA E VERIUT KANË MBAJTUR TAKIMIN E RADHËS NË KUADËR TË NISMËS “BALLKANI I HAPUR”

Themeluesit e “Ballkanit të hapur” firmosin marrëveshje të reja

Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë avancuar të martën agjendën e nismës rajonale “Ballkani i hapur”. Në samitin e radhës të kësaj nisme të mbajtur në Tiranë këto vende kanë nënshkruar disa marrëveshje që rritin bashkëpunimin mes tyre. Udhëheqësit e këtyre vendeve kanë ftuar edhe tri vendet e tjera të rajonit, Kosovën, Malin e Zi dhe Bosnjë Hercegovinën, që t’i bashkohen kësaj nisme. Të njëjtën thirrje e ka bërë edhe komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi i BE-së, Oliver Varhelyi, i cili i ka inkurajuar Ramën, Vuçiqin dhe Zaevin për vazhdimin e kësaj nisme

Kosovën, Malin e Zi dhe Bosnjë Hercegovinën që t’i bashkohen kësaj nisme. Sipas tyre, këto shtete nuk kanë alternativë tjetër. “A do t’ua kthejmë barrierat meqë tri shtetet e tjera s’duan t’i heqin barrierat për njerëzit e tyre? Patjetër që jo. Ky është ‘Ballkani i hapur’. Proces i çlirimit të forcave të punës nga të gjithë pengesat burokratike dhe zinxhirët e legjislacioneve të ndryshme. Është një unifikim sipas shëmbëlltyrës së BE-së. Kush do të vrapojë vrapon, kush do të ecë ecën, kush të rrijë në vend le të rrijë. Është i hapur. S’ndalet. Është interes strategjik i Shqipërisë dhe shqiptarëve përtej interesit rajonal. Dhe do të vijë në ‘Ballkanin e hapur’, vetëm se do të humbasin kohë”, ka thënë Rama në konferencën e përbashkët për medie pas takimit.

Sipas tij, vendet që nuk përfshihen në këtë nismë do të humbasin shumë. “Të gjitha do të fitojnë pjesën e tyre aq sa janë të zotë. S’u them hajdeni se po s’erdhët ju e lëmë këtë punë. Këtë punë e kemi nisur për Shqipërinë. Janë të mirëpritur. Mund të përfitojnë nga këto nisma. Por as s’do ta ndalin ‘Ballkanin e hapur’, as s’do ta ndryshojnë dot trajektoren që tash më s’kthehet prapa”, është shprehur ai. Edhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka deklaruar se kjo iniciativë është interes i secilit vend të Ballkanit Perëndimor. “S’është produktive për mua që t’i ftoj, sepse kur ftoj dikë nga Prishtina thonë se meqë ai po fton, s’do të vijmë. Por nëse do të kisha problem që ata të shfaqeshin, apo nëse do ta

zgjidhnim statusin e çështjes politike, kjo është në dialogun në Bruksel. Por, për lëvizjen e njerëzve, mallrave e kapitalit, jemi së bashku në kuadër të ‘Ballkanit të hapur’. Edhe Malin e Zi e Bosnjën i ftoj. Thjesht do të humbasin kohë. S’ka nevojë ta lutim askënd”, ka thënë Vuçiqi.

Ndërkaq kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka thënë se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të mbesin peng i dështimeve të Bashkimit Evropian. “Kur së bashku me Vuçiqin dhe Ramën krijuam dhe e përkufizuar këtë iniciativë, ne treguam që tri vendet tona nuk do të mbaheshin peng nga dështimet e Bashkimit Evropian sa i përket procesit tonë të integritimit në BE. Ky proces mund të ndalohej në Bruksel, por evropianizmi dhe

EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

Prishtinë, 21 dhjetor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kanë vazhduar realizimin e agjendës së nismës rajonale “Ballkani i

hapur”. Në takimin e radhës që është mbajtur të martën në Tiranë, përfaqësuesit e këtyre shteteve kanë nënshkruar pesë marrëveshje të cilat kanë për qëllim lehtësimin e bashkëpunimit rajonal. Liderët e këtyre vendeve kanë ripërsëritur thirrjen për

Arrestohet ish-kryetari i Shtërpcës dhe dhjetë persona të tjerë

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ish-kryetari i komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikolliq, u arrestua të martën nën dyshimet për keqpërdorim të pozitës zyrtare, bënë me dije autoritetet në Kosovë.

Shtërpca është një prej gjashtë komunave me shumicë serbe në jug të Lumit Ibër në Kosovë. Në krye të saj, që nga themelimi në vitin 2009 e deri në fund të nëntorit 2021, ishte Nikolliq nga radhët e Listës Serbe. Kjo është partia kryesore e serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Nikolliq, para se t'i bashkohej Listës Serbe në vitin 2013, ishte kryetar i Shtërpcës nga radhët e Partisë së Pavarur Liberale, e cila në fillim të vitit 2020 shpalli moratorium politik si pasojë e dominimit total të Listës Serbe. Ndaj arrestimit të

Kush tjetër u arrestua?

Pos Nikolliqit, Policia e Kosovës, me urdhër të Prokurorisë së Shtetit, arrestoi edhe rreth dhjetë persona në Shtërpcë, mes të cilëve drejtorin e Urbanizimit dhe disa zyrtarë e pronarë ndërmarrjesh, bëri me dije Prokuroria Themelore në Ferizaj. Ata dyshohen për veprat penale "marrje dhe dhënie e ryshfetit", si dhe "keqpërdorim i pozitës zyrtare".

tij reagoi Lista Serbe, e cila tha se e dënon "përdorimin e tepruar të forcës" dhe "aksionin brutal" që u krye në komunën e Shtërpcës. "Veçanërisht shqetësues është



fakti se gjatë këtij aksioni me deklaratat nga terreni, policia ka penguar lëvizjen, hyrjen dhe daljen nga komuna e Shtërpcës, të njerëzve të thjeshtë, përfshirë edhe ata që

kishin nevojë për ndihmë mjekësore", thuhet në deklaratën e Listës Serbe. Policia e Kosovës ende nuk ka dhënë hollësi të operacionit. Drejtori i Zyrës për Kosovën në

Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka thënë se kjo është "një tentativë tjetër brutale për ta frikësuar popullin serb në Kosovë" dhe "një terror i ri i kryeministrit Albin Kurti".

vlerat tona evropiane në tri shtetet tona nuk kanë arsye pse të presin", është shprehur Zaev. Përmes videolidhjes në takim është kyçur edhe komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Oliver Varhelyi, i cili i ka inkurajuar këto vende që ta vazhdojnë këtë nismë rajonale. "Admiroj faktin se sa fort e ndieni këtë nismë, se pikë së pari ka qenë një nismë që vjen nga Ballkani. Nuk është Bashkimi Evropian që doli me këtë nismë, por ka ardhur prej jush, prej tri aktorëve që shoh rreth tryezës edhe sot, dhe ju vazhduat të shtyni përpara edhe kur ne nuk arritëm ta tërhiqim pjesëmarrjen e gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor, sepse ju kuptuat rëndësinë e integritetit rajonal dhe sidomos mënyrën në të cilën kjo është në gjendje ta ndryshojë jetën e qytetarëve tuaj", ka deklaruar Varhelyi.

Ai ka bërë me dije se bashkimi i të gjithëve në këtë nismë do t'i ndihmonte bizneset. Sipas Varhelyit, edhe vendet e tjera të rajonit duhet t'i bashkohen kësaj nisme rajonale. "Më lini

që të përfitoj nga mundësia për t'i ftuar tre partnerët t'i kthehen këtij bashkëpunimi rajonal, sepse kjo nismë shton mundësitë për biznese. Gjithashtu, është në të mirë të konsumatorëve, por po kështu mund të ndryshojnë realitetet në terren që janë shumë të zymta", ka deklaruar Varhelyi.

Marrëveshjet e reja

Në takimin e Tiranës themeluesit e nismës "Ballkani i hapur" kanë nënshkruar pesë marrëveshje të reja të cilat pritet ta shtojnë bashkëpunimin në mes të këtyre vendeve. Marrëveshjet që janë nënshkruar nga këto tri vende janë: Marrëveshja për qasjen e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor; Marrëveshja për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor; dhe Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e veterinarisë, ushqimit, sigurisë ushqimore dhe fushën fidosanitare në



Ballkanin Perëndimor. Shqipëria ka nënshkruar edhe dy marrëveshje të tjera dypalëshe: Marrëveshjen dypalëshe në mes të Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë për njohjen e ndërsjellë të operatorëve të autorizuar ekonomikë për autorizimet e sigurisë dhe sigurimit; si dhe Marrëveshjen dypalëshe në mes të

Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë për njohjen e ndërsjellë të operatorëve të autorizuar ekonomikë për autorizimet e sigurisë dhe sigurimit. Liderët e këtyre shteteve kanë bërë me dije se këto marrëveshje do të fillojnë të zbatohen menjëherë. "Do të jenë të zbatueshme menjëherë

pas nënshkrimit. Do të fillojë puna", ka deklaruar kryeministri Edi Rama. Edhe presidenti serb ka thënë të njëjtën gjë. "Kur mbaron me nënshkrimet elektronike. Për të gjithë njerëzit në vendet tona do të nisë zbatimimi menjëherë, mund të ketë disa probleme teknike, por do të zgjidhen rrugës", ka deklaruar Vuçiqi.

Nisma "Ballkani i hapur" është iniciuar nga Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut në tetor të vitit 2019. Fillimisht ajo është quajtur "Mini-Shengen", e cila parasheh lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe njerëzve midis të tria vendeve.

Kosova, Bosnjë Hercegovina dhe Mali i Zi e kanë kundërshtuar këtë nismë. Përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës në Kosovë kanë vlerësuar se një nismë e tillë është e rrezikshme për shtetin e Kosovës.



Rama: Do t'i ftojme Italinë, Greqinë dhe Hungarinë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se në samitin vijues të "Ballkanit të hapur", i cili do të mbahet në shkurt, do të ftohen të marrin pjesë edhe Italia, Greqia dhe Hungaria. "Ka një prirje nga ata njerëz që nuk duan që ta ndjekin këtë nismë, apo që nuk duan që kjo nismë të ketë sukses. Kur thonë se kjo është alternativë ndaj BE-së apo kur thonë se kjo është të kthehesh në të shkuarën dhe të krijosh Jugosllavinë, 'Ballkani i hapur' nuk ka të bëjë fare me të. Në samitin e ardhshëm do t'i trajtojmë barrierat tarifore. Në samitin vijues duam ta kemi Italinë, Greqinë dhe Hungarinë", ka deklaruar Rama.

Agron Mehmeti emërohet në krye të QKMF-së në Skenderaj

SKENDERAJ, 21 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka emëruar përkohësisht dr. Agron Mehmetin në krye të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. "Gjendja e rëndë në këtë sektor është e

papranueshme, shkaqet dhe arsyet nuk mund të jenë të pakalueshme në raport me kërkesat dhe nevojat e qytetareve, andaj jemi të vendosur për t'i dhënë zgjidhje të duhur! Profesionalizmi, vullneti dhe angazhimi mbi

bazën e bashkëpunimit korrekt dhe të ndërsjellët janë çelësi i suksesit. Të priftë e mbara dhe suksese, dr. Agron Mehmeti, në krye të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare!", ka shkruar Nura në llogarinë e vet në "Facebook".



Mbahet dialogu ndërministror për arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Gjendja aktuale dhe synimet e Qeverisë së Kosovës rreth reformimit të Sistemit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) ishin në qendër të dialogut ndërministror për AAP-në.

Në hapje të takimit, kryeministri Albin Kurti foli për rëndësinë e arsimit dhe aftësimin profesional për zhvillim ekonomik të Kosovës. "Reformimi dhe harmonizimi i sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional luan rol vendimtar në plotësimin e hendekut të

shkathësive dhe në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit tonë", ka pohuar Kurti.

Ai ka shtuar se, përkundër raportimeve zyrtare për papunësi të madhe, industria nuk ka mundur t'i plotësojë vendet e lira të punës me punëtorë të kualifikuar, "pasi sistemi i arsimit dhe aftësimin profesional, pa marrë parasysh që u është nënshtruar reformave të shumta, nuk ka arritur t'u përshtatet nevojave të industrisë dhe tregut të punës", ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se për të tërhequr investime të huaja në vend, një nga faktorët kyç është fuqia punëtore e kualifikuar. "Duke qenë shteti me popullsinë më të re në Evropë, është e domosdoshme që rinia jonë të shkollohet dhe trajnohet me aftësi profesionale, për t'i shërbyer zhvillimit shoqëror", ka deklaruar kryeministri, duke shtuar se nëpërmjet arsimit dhe aftësimin profesional do të mund të shtohen vendet e punës, të ulet varfëria dhe të zbutet pabarazia. "Do të duhej që edhe si

institucione me përgjegjësinë tonë, por edhe si shoqëri me vetëdijen tonë, ta ngrehim më lart profesionin dhe profesionalizmin joakademik. Pra është e mundshme të jesh profesionist edhe pa qenë akademik", është shprehur Kurti, duke ritheksuar se si institucione dhe shoqëri duhet të ndikojnë te ngritja e reputacionit të profesionistëve joakademikë dhe tek autoriteti i tyre.

Në këtë takim u paraqitën të gjeturat nga analiza e ndërmarrë nga Fondacioni Evropian i

Trajnimeve (ETF), me titull "Rishikim i sfondit për ta informuar dialogun mbi politikën në Kosovë për qeverisje dhe financim të AAP" dhe u dhanë propozime për ndërmarrjen e hapave të ardhshëm.

Gjatë këtij takimi u dhanë propozime rreth fuqizimit të bashkëpunimit me industrinë, si dhe lidhjes në mes të parashikimit të zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të fuqisë punëtore përmes arsimit dhe aftësimin profesional.



Shoqërohen në polici shtatë persona për bixhoz të paligjshëm



Ferizaj, 21 dhjetor (ER) - Të martën në orët e hershme të mëngjesit në orën 03:10, Policia Rajonale e Ferizajt gjatë patrullimit ka hasur në një lokal në rrugën "Ilir Konushevi" në Ferizaj, ku dyshohej se disa persona ishin duke zhvilluar aktivitetet joligjor, duke luajtur bixhoz.

Njësitë reaguese, të mbështetura edhe nga hetuesit e

Stacionit Policor të Ferizajt, kanë reaguar dhe aty kanë hasur shtatë persona duke luajtur bixhoz. Me këtë rast, policia ka marrë veprimet e duhura hetimore, duke bërë fotografimin dhe si dëshmi materiale kanë gjetur 248 çipa që konvertohen në shuma të caktuara të parave gjatë lojës, tri palë letra që janë përdorur për të luajtur bixhoz të cilat edhe janë

konfiskuar.

Pasi janë kontrolluar personat e dyshuar, ata janë shoqëruar në Stacionin Policor në Ferizaj. Pas intervistimit nga policët e Njësisë së Hetimeve, me vendim të prokurorit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj është iniciuar rasti penal "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm" për procedura të mëtejme hetimore.

Vazhdon vaksinimi kundër Covidit në shkollat e Lipjanit

LIPJAN, 21 DHJETOR (ER) - Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, Merita Bytyqi, së bashku me drejtoreshën e Arsimit në Lipjan, Elmaze Behluli, kanë vizituar Shkollën Filllore "17 Shkurti" në Gllgovc për të

parë për së afërmi procesin e vaksinimit kundër Covidit te nxënësit e kësaj shkolle. Me këtë rast, drejtoresha Bytyqi ka theksuar se deri më tani shumë nxënës i janë përgjigjur si duhet marrjes së vaksinimit dhe nuk ka

ndodhur asnjë komplikim apo efekt anësor. "Shpresojmë që kësaj thirrje t'i bashkohen edhe shumë nxënës të tjerë për shëndet më të mirë dhe mirëqenie siç edhe e meritojnë", është shprehur Bytyqi.



Nënshkruhet marrëveshja për abetaren e re të përbashkët Kosovë - Shqipëri

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka pritur të martën në takim ministren e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Evis Kushi, me bashkëpunëtorë, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për Abetaren e re të përbashkët unike Kosovë - Shqipëri.

Të dy ministret e Arsimit theksuan përkushtimin për të mundur që Abetarja e re të jetë në përdorim për nxënësit e të dy vendeve nga viti shkollor 2022/23 për nder të 110-vjetorit të Pavarësisë.

Ministrja Nagavci dhe Kushi falënderuan grupin punues të dy ministrive për punën që kanë bërë për ta finalizuar marrëveshjen e nënshkruar, ndërsa u zotuan se i tërë procesi për Abetaren e re do të jetë transparent dhe i barabartë.

Ministrja Nagavci ka shprehur kënaqësinë e saj të veçantë për zyrtarizimin e marrëveshjes për përdorimin e një Abetare të përbashkët për të gjithë vogëlushët shqiptarë e cila do të jetë cilësore.

Nagavci, po ashtu, ka theksuar se gjatë vizitës që kishte në muajin



qershor në Shqipëri, diskutuan për obligimet që kanë si institucione të arsimit në mënyrë që të jenë në hap me kërkesat e qytetarëve të të dyja vendeve.

Ndër të tjera, ministrja Nagavci ka thënë se si ministre e Arsimit janë të përkushtuara që të ketë bashkëpunim të shtuar edhe në

aktivitete të tjera të përbashkëta kulturore dhe sportive.

Ndërsa ministrja e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë, Evis Kushi, ka thënë se nuk e kishte menduar që vizita e saj zyrtare në Prishtinë do të përkonte me një moment kaq emocionues dhe kaq krenar, siç është nënshkrimi i marrëveshjes

për Abetaren e përbashkët unike për të dyja vendet tona.

Ministrja Kushi foli edhe për marrëveshjen e përbashkët të nënshkruar në Elbasan për lehtësimin e procedurave dhe shkurtimin e afateve për njohjen e diplomave, kualifikimeve dhe gradave shkencore të studiuesve

nga të dyja vendet, si dhe për promovimin e librit për gjuhën dhe kulturën shqiptare për diasporën.

Kosova dhe Shqipëria që nga viti 2012 kanë pasur Abetaren e përbashkët, e cila është ende në përdorim në sistemin arsimor të Kosovës.

MSh-ja, qytetarëve: Merrini të gjitha dozat e vaksinës kundër Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë përmes një njoftimi për medie ka bërë thirrje që të merren të gjitha dozat e vaksinës kundër Covidit, edhe doza e tretë përforcuese. Vetëm kështu, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, arrihet niveli maksimal i mbrojtjes kundër këtij virusi. "Nuk mjafton nëse keni marrë vetëm një dozë të vaksinimit dhe nuk jeni vaksinuar plotësisht. Niveli maksimal i mbrojtjes arrihet vetëm nëse i merrni të gjitha dozat e rekomanduara të vaksinës kundër Covid-19. Kudo në Kosovë ju tani mund ta merrni edhe dozën përforcuese dhe dozën e tretë!", ka njoftuar MSh-ja.

Ministria e Shëndetësisë, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, ka informuar të martën se nga 1 802 testime, 9 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. MSh-ja ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të martën janë shëruar 6 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarëve është 157 971. Në total numri i rasteve aktive është 314.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 2 096 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 656 937 doza të vaksinës. Deri më sot 777 730 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Ministri i Shëndetësisë: Kam ardhur t'ia kthej borxhin Kosovës

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, të martën në Komisionin për Shëndetësi ka theksuar se nga Amerika ka ardhur në Kosovë me një qëllim të thjeshtë, për t'ia kthyer borxhin Kosovës. Ai ka thënë se për ta rregulluar

shëndetësinë në Kosovë e botë në realitet është lehtë, nuk është vështirë fare, por vetëm nëse është ideja dhe koncepti kush po na duhet dhe për çka po punojmë. Latifi ka thënë se si kuadër ai është përgatitur këtu, pasi ka kryer Fakultetin e Mjekësisë

në Prishtinë, e pastaj ka vazhduar shkollimin në ShBA. "Kam ardhur me një qëllim të thjeshtë, për t'ia kthyer borxhin Kosovës", ka thënë ai. Ministri Latifi ka thënë se pa punuar si ekip nuk mund të përmirësohet sektori i shëndetësisë në Kosovë.



Avokati i Popullit: Vendimi i ZRRE-së për pagesën e rrymës në veri është diskriminues

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Avokati i Popullit vlerëson se mbetet shqetësuese mbrojtja e të drejtave në punë dhe, sipas tij, raste të tilla përbëjnë 12 për qind të numrit të ankesave që janë dorëzuar në këtë institucion gjatë këtij viti. Drejtuesi i këtij institucioni, Naim Qelaj, thotë se qytetarët në Kosovë vazhdojnë të përballen me zvarritje të procedurave gjyqësore.

Avokati i Popullit ka bërë me dije se gjatë këtij viti ka pranuar 1 536 ankesa, raste këto në të cilat janë të përfshirë 2 387 persona të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre.

Në një konferencë për medie, Qelaj thotë se vazhdojnë ta

konsiderojnë diskriminues vendimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për pagesën e rrymës në veri.

Ndërsa lidhur me krizën energjetike në vend dhe vendimin e qeverisë për mbështetje të KEK-ut, ai thotë se ende nuk kanë ndonjë qëndrim veçse thekson se nëse konstatojnë që ka shkelje të të drejtave të njeriut do të reagojnë.

Ndërsa nga ankesat e paraqitura nga qytetarët, 665 raste janë hapur për hetim dhe në këtë numër përshihen edhe 44 raste të hapura sipas detyrës zyrtare dhe 12 raste të cilat janë hapur pas raportimit të medieve.



Finalizohet projekti i pistës së ANP 'Adem Jashari', zgjatet për 540 metra

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" është finalizuar projekti i zgjatjes së pistës dhe ngritjes së kapacitetit të ndriçimit.

Pista është zgjatur nga 2 500 metra në 3 040 metra.

Ministri i Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu,

ka thënë se është një moment i rëndësishëm meqenëse përfundimi i këtij projekti ka ndikim në transportin ajror në vendin tonë dhe krijon kushte për të ardhmen për transport të mallrave.

Aliu, po ashtu, ka theksuar se tashmë me instalimin e sistemit të teknologjisë më të lartë të parashikimit të motit mundësitë për anulim të fluturimeve janë zvogëluar. "Projekti tashmë

është i finalizuar dhe është operacional dhe janë instaluar edhe pajisjet e sofistikuar për aterrim. Kemi të instaluar sistemin e ri të navigimit, është bërë trajnimi për shfrytëzim, është instaluar aterrimi përmes navigimit me instrumente ILS, është instaluar edhe sistemi meteorologjik. Aeroporti i Prishtinës është tash në nivel të konkurrueshmërisë në rajon. Pista e këtij aeroporti është më e

përshtatshme se aeroportet e regjioneve dhe sa iu përket sistemeve të avancuara 3B nga sistemi dy që e kemi pasur më parë është një renditje e lartë", ka thënë Aliu.

Gjenerali i KFOR-it, Ferenx Kajari, ka pohuar se aeroporti i Prishtinës ka krijuar një infrastrukturë shumë të mirë dhe ka avancuar në këtë hapësirë. Sipas tij, përmirësimet e infrastrukturës janë hap

pozitivë për aviacionin në Kosovë dhe në përgjithësi për regjionin e Ballkanit.

Ndërsa drejtori i Operimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, Gokmen Arityay, ka thënë se është krenar për realizimin e këtij projekti. "Jemi krenarë që tashmë kemi arritur të finalizojmë këtë projekt dhe se do të kemi mundësi ta zhvillojmë transportin ajror", ka deklaruar Arityay.



Fillon rikthimi i vlerës së lirës turke

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Lira turke ka shënuar një kthesë të madhe të hënën në mbrëmje pasi presidenti Rexhep Tajip Erdogan ka paraqitur një sërë hapash që, sipas tij, do ta lehtësojnë barrën e monedhës. Erdogan ka thënë se do të

vazhdojë me një politikë të normave të ulëta të interesit. Valuta e Turqisë, e cila më parë ra më shumë se 11 për qind kundrejt dollarit, brenda një dite u forcua rreth 15 për qind. Aktualisht po tregtohet me 0.0747 dollar. Duke folur pas

një takimi me kabinetin qeverisës, Erdogan ka thënë se masat do të siguronin që qytetarët të mos i konvertonin lirat në valutë të huaj gjatë rënies së kësaj monedhe, përfshirë edhe një premtim për garancinë e depozitave.



Viti 1921: Shpallja e Republikës së Mirditës, me ndihmën e Serbisë


Komunizmi nis të përhapet nëpër botë. Më 1921 formohet Partia Komuniste e Italisë, e Çekosllovakisë, e Portugalisë, e Spanjës, e Kinës ... Ushtria e Kuqe invadon në Gjeorgji, ndërsa ndodh puçi ushtarak i udhëhequr nga Reza Khan dhe Zia'eddin Tatabaee, që më 1925 do të sjell fundin e dinastisë Qajar në Iran.

Cilat janë ngjarjet që kanë shënuar shqiptarët dhe botën në vitin 1921?

Në Irlandë vazhdon lufta për pavarësi, me sulme ndaj forcave britanike. Luftimet marrin fund më 6 dhjetor, kur Traktati Anglo-Irlandez e pranon Shtetin e Lirë të Irlandës që përfshinte 26 prej 32 konteve irlandeze.

Më 12 mars, Marshi i Pavarësisë miratohet si himn zyrtar i Turqisë.

